



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02Nr. *400/21-19177/ur*
Dt. 21.08.2025

Në bazë të thirrjes publike për organizimin e panairit me produkte vendore lokale me nr. të protokollit 09Nr.020/01-16899/25 e dt. 05.08.2025, nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. Duke u bazuar në Thirrjen Publike për organizimin e panairit me produkte vendore-lokale, me nr. protokollit 09Nr.020/01-16899/25 të datës 05.08.2025, e cila ka pasur afatin e aplikimit nga dt. 06.08.2025 deri më 20.08.2025, **afati i aplikimit vazhdohet edhe për 7 (shtatë) ditë të tjera, nga dt. 21.08.2025 deri më dt. 27.08.2025.**
- II. Zgjatja e afatit bëhet pasi që, sipas kushteve të përcaktuara në thirrjen publike, është theksuar se **“të drejtë aplikimi kanë vetëm OJQ-të e regjistruara në Regjistrin e Organizatave Joqeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit”.**
Gjatë periudhës së parë të aplikimit nuk ka aplikuar asnjë OJQ lokale, dhe për këtë arsye është bërë zgjatja e afatit.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë së Bujqësisë, Turizmit, Zhvillimit Rural dhe Inspekcion,
- Zyrës për Informim dhe
- Arkivit të Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Dr.Bexhet Xheladini